



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:091076

Datë: 07.10.2024

Numri i dokumentit: 06258190

C.nr.1681/202

4

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Dora Bajrami, në çështjen juridike kontestimore të paditëses L.G.H. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqësojnë B.K. dhe F.G. që të dy avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimin e diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguara, vlera e kontestit 1,107.00 euro, jashtë seancës, më datë 07.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

- I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses L.G.H. nga Prizreni,
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për periudhën kohore prej datës 01.05.2021 deri më datë 31.12.2022 apo për 20 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë – 421 euro, t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,107.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë me datë 13.02.2024, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET e paditura, që paditëses, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 134.00 euro, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja L.G.H. nga Prizreni, përmes të autorizuarve të saj, pranë kësaj gjykate me datën 18.03.2024, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit–Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguara, nga data 01.05.2021 deri me datën 31.12.2022, në shumën prej 1,107.00 euro.

Në referatin e padisë ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune në shkollën “Bajram Curri” në fshatin Romajë Komuna e Prizrenit, dhe që është e licencuar Meqenëse se paditësja është e licencuar dhe e kualifikuar mësimdhënës e me titull Baçellor Program fillor, bazuar në

nenin 3 dhe 4 të Vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.01/33, të datës 29.08.2008, është paraparë ngritja e pagave për mësimdhënësit, drejtorët, bashkëpunëtorët profesional në nivelin fillor dhe atë të mesëm, dhe atë me diplomë të shkollës së normale prej 10%, me diplomë të shkollës së lartë pedagogjike prej 19%, me diplomë universitare 3 dhe 4 prej 27% dhe me diplomë master dhe doktoraturë prej 35%. Nga të lartcekurat paditësja në bazë të kontratës së punës, realizon pagë bazë 421 euro, ndërsa shtesën prej 27% e kësaj page apo shuma prej 113.67 euro e paditura ia paguan pjesërisht dhe atë vetëm 58.32 euro, duke i mbetur borxh shumë prej 55.35 euro. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet padia e paditësës në shumën prej 1,107.00 euro nga data 01.05.2021 deri me datën 31.12.2022, për 20 muaj. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësës vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë 156.00 euro dhe taksën gjyqësore 30.00 euro.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 07.08.2024, ku ka theksuar se pretendimet e paditësës se i takon kompensimi deri më 31.12.2022, janë ta pabazuara për arsye se në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 e datës 05.10.2023, rastet e të punësuarve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, duhet trajtuar deri me datë 21.11.2022, kur kjo kontratë është shkëputur nga njëra prej palëve kontraktuese. Po ashtu ka theksuar se në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/ të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpadija e paditësës është e pa bazuar. Pretendimet e paditësës se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësja ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të saj pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj, çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësës nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësës se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësës ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK, gjeti se kërkesëpadija e paditësës është e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja L.G.H. është në marrëdhënie pune tek e paditura shkollën “Bajram Curri” si mësimdhënëse. Mirëpo,

kontestuese ishte nëse paditëses i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të paguar.

Në këtë drejtim, gjykata gjeti se paditësja ka diplomuar me datë 30.08.2016 dhe ka marr titullin profesional Baçellor Programi fillor dhe ka licencë të karrierës – Diploma nr. 409 e dt. 30.08.2016. Nga vërtetimi me numër të protokollit 210/21 i datës 05.06.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja Leonita Gashi është në marrëdhënie pune në shkollën “Bajram Curri ” dhe atë prej dt. 11.09.2017. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 421 euro dhe se paditëses në emër të kualifikimit, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se *“shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarra apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia falë besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që *“nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se *“mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*. Pastaj, bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që *“për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”*, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëses t’ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ia ka paguar shumën prej 58.32 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësja përfiton ngritje prej 27 % të pagës bazë, që në rastin konkret paditësja përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 113.67 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditëses për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 55.35 euro apo diferencën e mbetur për 20 muaj, nga data 01.05.2021 e deri më datë 31.12.2022, në shumë të përgjithshme prej 1,107.00 euro (20 x 55.35 = 1,107.00) euro.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadsë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*, andaj ka vendosur si në pikën nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padsë në këtë gjykatë (08.03.2024), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par.1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 124.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padsë shumën prej 104.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 30.00 euro. Ndërsa gjykata nuk ia njohu diferencën e kërkuar prej 22.00 euro, pasi që sipas Tarifës së Odës së Avokatëve në kontestet me vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri në 10,000 euro përpilimi i parashtrësve është në vlerë prej 104.00 euro dhe jo 156.00 euro sa ka kërkuar i autorizuari i paditëses.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 dhe 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.1681/2024, me datë 07.10.2024

Gjyqtarja

Diora Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.